



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:225576

Datë: 08.05.2024

Numri i dokumentit: 05666807

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr..../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas gjyqtarit Musë Povataj me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të akuzuarit I.... N..... për shkak të veprës penale legalizim i përmbytjes së rreme nga neni 395 par 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshme PP/II-nr.1691/21 të datës 11.10.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë, dhe të hapur për publikun, në prezencë të Prokurores së Shtetit Ardiana Veseli, të akuzuarit I.... N..... dhe mbrojtësi i tij av. S..... M.....sipas autorizimit me datë 11.04.2024 mori dhe shpalli publikisht ndërsa me datës përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

I... N..., i lindur me, në fsh. R... A....., Komuna P..., me banim në Pejë, rr.M.... L....” pa nr. i biri i U..... dhe E....., e gjinisë L...., ka të kryer shkollimin e lartë, me profesion bujk, i martuar, me gjendje të dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr.#....., posedon telefon me nr., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

Konform nenit 363 par. 1 nën par. 1.3 të KPPRK-së.

LIROHET NGA AKTAKUZA

Për shkak se:

Me dt....., në Q..... për K..... e a..... në P....., tenton të vë në lajthim organizon kompetentë i cili ka autorizime për të vërtetuar çështje të caktuara sa i përket automjeteve ashtu që i njëjti edhe posë ka pasur njohuri se i njëjti automjet edhe një herë ka qenë në të njëjtën qendër, i pandehura me datën e lartcekur paraqet kërkesë për inicimin e kontrollit të veturës “F.... T....”- me targa të huaja e me të dhëna të detajuara si në shkresat e lëndës, mirëpo i njëjti nuk arrin që të vërtetoj një çështje të pavërtetë apo ta kaloj homologimin për shkak të parregullsive dhe atë për shkak se pas ekzaminimit nga ... rezulton se numri i karrocërisë së kësaj veture nuk gjendet aty ku duhet të jetë sipas standardit EUVID,

- -me çka kishte për të kryer veprë penale legalizim i përmbytjes së rreme e mbetur ne tentativë nga neni 395 par 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Të pandehurit i kthehet veturës “F... T...” ...- ., me nr. të shasis W....., me targa të huaja e me të dhëna të detajuara si në shkresat e lëndës, menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve.

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme ka ngritur aktakuzën PP/II-nr.1691/21 të datës 11.10.2021, ndaj të akuzuarit I..... N..... për shkak të veprës penale legalizim i përmbytjes se rreme nga neni 395 par 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Me aktgjykimin P.nr./. të datës i akuzuar I..... N....., është liruar nga aktakuza për shkak të veprës penale legalizim i përmbytjes se rreme nga neni 395 par 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Pas parashtrimit të anekses nga ane Prokurorisë Themelore në Pejë Gjykata e Apelit me aktvendimin PA1.nr...../.... datës e ka anuluar aktgjykimin e kësaj gjykate P.nr...../. të datës dhe çështjen e ka kthyer ne rivendosje.

Me datën, dhe gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor të hapur për publikun, në prezencë të Prokurores së Shtetit Ardiana Veseli, të akuzuarit I..... N..... dhe mbrojtësi i tij av. S..... M.....sipas autorizimit

Prokurorja e shtetit Ardiana Veseli në fjalën përfundimtare drejtpërsëdrejti procesverbal ka deklaruar: ne mbështetje te nenit 351 te KPERK0-së paraqes pran kësaj gjykata fjalën përfundimtare sipas aktakuzës PP/II-nr.1691/21 të datës 11.10.2021, kundër te pandehurit I..... N..... për shkak të veprës penale legalizim i përmbytjes se rreme nga neni 395 par 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së. Me provat personale dhe materiale e gjate këtij shqyrtimi gjyqësor nuk është kontestuar fakti se kamioneta e sekuestruar nga i pandehuri I..... N..... rezulton se e njëjta e ka te fshirë numrin e karrocerisë e cila nuk gjendet aty ku duhet te jetë sipas standardit EU-VD, një fakt i tillë citohet nga raporti i ekspertimit AKP/2021-....., me konstatimin se kamioneta F..... transit model ngjyrë e verdh me rimorkio ku tek ky mjet numri i karrocerisë nuk gjendet aty ku dehet te jetë sipas standardit EU-VD. po ashtu edhe gjate këtij shqyrtimi gjyqësor i ftuar ne cilësi te dëshmitarit eksportit i balistikes sqaron se. Me te pranuar urdhëresën për ekzaminim te numrit te karrocerisë gjate inspektimit dhe ekzaminimit forenzik kemi konstatuar se kamioneta ne fjalë e ka te dëmtuar pra fshir komplet numrin e karrocerisë e i cili duhet te jeto pas gomës se parë ballore pragu i djathtë dhe kemi vërejtur tiketën plastike te tipit e cila është e vendosur ne shtyllën e derës se par krahu i djathtë, tek e cila nuk është vrenjtur ndonjë ndërhyrje, ky numër i karrocerisë është dashur te jetë pas gomës se par ballore krahu i

djathtë duke shtuar sa janë vërejtur gjurmë veglash te cilat përdoren për rrafshimin dhe pastrimin e sipërfaqes metalike. Ku sipas ekspertit te gjitha veturat ne tregun evropian duhet te kenë numrin e karrocisë e te shtypur e qe duhet ti përmbaj 17 karaktere. Këtu i pandehuri ne fjalë deklaronte se veturën e ka blerë nga një person qe nuk ja dinë emrin duke ju referuar një shqiptari te maqedonasi dhe atë ne Zvicër ku në momentin e blerjes nuk ka përpiluar kontratë shitblerje me shitësin , vetuar është sjell ne Kosovë , nuk është doganuar , ku i pandehuri deklaronte se unë kam qen viktimë pasi qe aty duhet te jen shtypur numrat e karrocisë. Gjata këtij shqyrtimi gjyqësor është dëgjuar edhe dëshmitar J..... N..... i cili deklaronte se kamioneten ne fjalë e kishte marrë babi i tij nga I..... N..... si kompensim për punët e kryera ne ndërtimtari , duke shtuar se meqë tabela ishte ne tabela te huaja kur e kam dorëzuar në homologim më kanë thënë se kjo vetura nuk bën te regjistrohet pasi mungojnë numrat ,pastaj veturën ma kanë kthyer ku edhe unë jam kanë kthyer lmerit duke e len ene oborrit e shtëpisë se tij. Andaj edhe pse këtu i pandehuri ishte ne dijeni se kishte një defekt dhe nuk ishte ber homologim herën e parë i enti duke e ditur se vetura nuk është në gjejnë te rregullt e merr kamioneten dhe dërgon ne Q.. ku dhe te njëjtin i thonë te lajmërohet ne polici. Nga te lart cekurat ne veprimet e te pandehurit I..... N..... realizohen elementet e veprës penale e veprës penale legalizimi i përmbajtës se rreme nga neni 395/1 lidhur me nenin 28 te KPRK-së, mbetemi ne tersi pran aktakuzës, përshkrimi faktit dhe juridik te vepër penale duke i propozuar gjykatës qe te akuzuarin I..... N.....n ta shpall fajtor duke i përcaktuar edhe dënimin për ketë vepër penale dhe i propozojmë gjykatës qe te behet konfiskimi i Përshkrahës i KAMIONET e me urdhër te gjyqtës UGJK.nr.../... te datës pasi i njëjti nuk mund te vihet ne qarkullim për shkak te parregullsive dhe nijeti te dërgohet ne agjencin për administrimin e pasurisë se sekuestruar apo te konfiskuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. S..... M..... në fjalën përfundimtare drejtpërsëdrejti procesverbal ka deklaruar: fjalën time e kam përgatit ne formë te shtuar dhe ju lus qe te njëjtin ta konsiderojnë si pjesë te procesverbali te kësaj seance dhe pjesë përbërës te shkresave te lendes.

I akuzuarit I..... N..... në fjalën përfundimtare drejtpërsëdrejti procesverbal ka deklaruar: pajtohem ne tersi me fjalën e mbrojtësit tim, unë po te kisha dit as qe do ta kisha blerë as nuk kisha me sjell ne Kosovë, as nuk do ta kisha dërguar ne homologim sepse unë kam pas mundësi me kthye parape ne Zvicër.

2. Provat e administruara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor

Gjykata për vërtetimin e plotë dhe të drejte të gjendjes faktike gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka dëgjuar ekspertin e forenzikes L..... M....., dëshmitarin J.... N.... , ndërsa në gjykatë gjatë shqyrtimit janë administruar këto prova materiale; Raporti i oficerit F.... M.... PK#4336 i datës 04.6.2021, deklarata e te dyshuarit I..... N..... e dhënë në Polici me datën 04.06.2021, Njoftimi i Q.. i datës 04.06.2021, Janë shikuar foto dokumentacioni i Q.., vërtetimi mbi sekuestrimin e automjetit, raporti i ekspertimit AKF/2021-..... i datës 07.9.2021, deklarata e te pandehurit e dhënë në Polici me datën 07.10.2021, Urdhri i Gjykatës Themelore UGJK.nr.../.. i datës, si dhe gjykata ka dëgjuar mbrojtën e të akuzuarit.

2.1 Deklaratat e dëshmitareve- eksperteve

2.1.1. Eksperti i forenzikes L..... M..... gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës ka deklaruar se: me te pranuar urdhëresën për ekzaminim të nurit të karrocërisë, gjatë inspektimit dhe ekzaminimit forenzik kemi konstatuar se kamionëta në fjalë e ka të dëmtuar (fshirë komplet numrin shtypur të karrocërisë i cili duhet të jetë pas gomës së parë në ballorë pragu i djathtë dhe kemi vërejtur tiketën plastike të tipit e cila është e vendosur në shtyllën e derës së parë krahu i djathtë, të cilat nuk janë vërejtur ndonjë ndërhyrje, ky numër i karrocërisë është dashur të jetë pas gomës së parë në ballorë krahu i djathtë.

Ndërsa në vendin ku është dashtë të jetë i shtypur numri i karrocërisë janë vërejtur gjurmë veglash të cilat përdoren për rrafshimin dhe pastrimin e sipërfaqeve metalike, kjo është tera, dhe e bazuar në standardet evropiane të veturave EUVID vetura duhet të ketë numrin e shtypur të karrocërisë sepse është identiteti i mjetit dhe posedon karakteristikat specifike të sigurisë. Tutje i eksperti ka deklaruar: në bazë të standardit evropian të gjitha votuarat që prodhohen apo për tregun evropian duhet të kenë numrin e karrocërisë i cili përmban 17 karaktere. Tutje në pyetje të mbrojtjes eksperti ka deklaruar se: **është i shkruar numri shasis në tiketën plastike dhe është numër vizual i cili është i vendosur nën parafango dhe në atë tikek nuk janë vërejtur ndërhyrje.**

Në pyetjen tjetër të mbrojtjes; kemi konstatuar se në tiketën plastike që gjendet në derë dhe në parafango e automjeti është i shkruar numri i shasis, a mund të thoni se a ka pas ndërhyrje qoftë në plastikën e derës qoftë në parafango, eksperti është përgjigjur: nuk ka pas ndonjë konstatim që është vërejt diçka, këto dy tiketa janë origjinale mirëpo vetëm numri i shtypur i karrocërisë është i fshirë.

Tutje i eksperti në pyetje të gjykatës ka deklaruar se: se përpos atij numri të shasis i cili është i fshirë **numër tjetër të shasis nuk ka të shtypur ngjashmësi është i prodhuar**, në laborator kemi terminologji shkencore dhe mund të deklarojmë se kjo veturë nuk është sipas standardit EU-VI-B dhe nëse nuk mund të bëjë kualifikim në këtë rast nëse vetura është origjinale apo e falsifikuar, ndërsa numrat e cekur në kapakun e motorit me të njëjtin nuk mund të bazohem sepse është pjesë zëvendësuese shumë lehtë.

2.1.2 Dëshmitari J... N... gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës ka deklaruar: babi im e ka marrë në kompensim një automjet për ndërtim nga i pandehuri I..... N....., ka qenë llojit kombi me dy përparë ulëse, këtë veturë e kemi marrë para 3 ose 4 vite, marrëveshja për kompensim është bërë në mes babit tim dhe I...., nuk e di nëse marrëveshja është bërë para se me ardhjen e automjetit ose pasë, këtë veturë babai im e ka marrë menjëherë si kanë bërë kontratë verbale ka ardhjen e automjetit dhe na u ka dorëzuar, ndërsa me këtë automjet nuk e kemi përdorur sepse ka qenë me tabelë të huaja, tek në ky automjet ka qëndruar një muaj, *ne homologim për herë të parë kam shkruar unë*, dhe kur kam shkruar mi dorëzuar dokumentet dhe pagesat, është hyrë në rend vetura, *dhe pastaj me kanë thënë se kjo veturë nuk është me u regjistruar*, arsyeja nuk i gjejshin numrat apo se diçka ka qenë në pyetje mirëpo kur e kanë quënë në objektin tjetër atëherë se diçka kanë bërë sepse nuk me kanë lenë mu afër, mirëpo pastaj me kanë thirrur dhe me thanë merre veturën, pastaj e kam quënë veturën në oborr dhe ja kemi kthyer veturën I...., ndërsa diçka me ka thënë I... nuk me kujtohet, mirëpo veturën e ka kthyer babi im, nuk e di nëse kjo veturë ka shkruar prap në homologim.

Ne pyetje te gjykatës dëshmitari ka deklaruar: e kemi shiku veturën dhe u shihke ne gjendje te rregullt, diçka pa rregullsi nuk kemi vërejt ngase po te kishim vërejt ne nuk do te kishim pranua me ba marrëveshje për kompensim, unë se kam shiku nëse ka pas numra te shtypura te shasis, por nëse nuk kishte me qenë ne rregulle vetura nuk ka mund te qlajmërohet ne Z.... dhe nëse ka pas ndonjë aksident vetuar ne se kemi shiku.

2.2 Provat materiale

2.2.1. Nga raporti i oficerit F.... M.... i datësështë vërtetuar se Njësi i Auto-Krimeve te Policisë se Kosovës është informuar nga Q.. lidhur me rastin dhe se me pas janë ndërmarr veprimet e nevojshme policore, faktet të cilat nuk janë kontestuese.

2.2.2. nga njoftimi i Q.- i datës është vërtetuar se në këtë organ është parashtruar kërkesa për homologlimin e kamionetes F.... T..... ngjyrë e mirëpo automjeti nuk e posedonte numrin e shasisë ne vendin e caktuar nga prodhuesi, poashtu edhe ky fakt nuk është kontestues.

2.2.3. nga fotografitë e kryera nga Q... është vërtetuar poashtu vetura ka hyre ne procedurën e homologimit dhe se vendi ku duhej te ishin numrat e shasisë sipas prodhuesit, nuk ndodheshin aty.

2.2.4. nga Raporti i ekspertizës se AKF-se me numër 2021-..... i datës poashtu është vërtetuar se *vetura është ekzaminuar dhe pas ekzaminimit ka rezultuar se numri i karrocërisë nuk gjendet aty ku duhet sipas standardit EUVID.*

2.3 Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari në mbrojtjen e tij dhënë në shqyrtim gjyqësor, në mes tjerash ka thënë se: Këtë automjet e kam blerë një javë para se me sjellë në Kosovë, ka qeni paisur me te gjitha dokumentet sa imperfekt lejes se regjistrimit , kontrollit teknik dhe sigurimit, kur e kam sjell ne Kosovë ka qenë me tabela te rregullta, atë automjet unë nuk e kam përdorur ne Kosovë.

Tutje i pandehuri ka deklaruar: arsyeja pse kam qenë ne Q.. personalisht, ka qenë dokumenti te cilin e kam marr ne F..... garazh në Z....., aty e kam dërgua dokumentin dhe tiketën te cilën ka ne prag, dhe atë tiket nuk ta lëshojën nëse vetuar nuk është në gjendje te rregullt,

Në pyetje të mbrojtjes së çka ndodhur në homologim, i akuzuari ka deklaruar: ka dal një person jashtë ka shiku se nuk i ka numrat e shtypur dhe me ka thënë qoje ne parking ne Pejë, unë tani nuk e di se ku gjendet kjo veturë, ne garazh ku e kam ble veturën dokument nuk kam marr mirëpo ne tel i kam te dhënat se e kam ble dhe kam kontaktuar me te, kontratë skam pas për te, unë e kam blerë veturën nga personi privat, unë kam menduar se kur është automjeti i regjistruar ne Zvicër nuk guxon qe te jetë i pa rregullt, pasi e kam ble unë e kam regjistrua ne Zvicër.

Ndërsa në pyetje të Prokurorisë i pandehuri ka deklaruar: po, a është e vërtet se veturën F... e kam blerë ne Z.... dhe e kam sjellë në Kosovë, në momentin e blerjes a nuk kam përpiluar

kontratë me shitësin, ne momentin kur e kam sjell automjetin vetura nuk është doganuar, nuk jam njoftuar nga Q.. se ne atë vetuar ka fshirje ne numra te shasis.

Tutje në pyetje të Prokurorisë i pandehuri ka deklaruar: nuk me ka njoftuar dikush se vetuar ka problem, mirëpo unë kam dërguar veturën ne parkingun e policisë pastaj, kur njoftuan policia për numrin e shasis unë e kam pyetur shitësin dhe me tha kthe veturën dhe unë ja qesë numrat, sepse ata i marrin numrat te cilët i ka pasur përpara dhe nuk e kontrollojnë sepse po ta kisha dit unë se kisha blerë kurrë,

Tutje ne pyetje të gjykatës i akuzuari ka deklaruar: unë kam blerë veturën pa kontratë nga një shqiptar i Maqedonisë te cilit emrin tani nuk ja di, unë nuk dyshoj se aj me ka shit ndonjë veturë e cila nuk është ne rregull, te njëjtin nuk e kam lajmëruar ne polici sepse unë se di a ka ber ndonjë falsifikim, unë e di qe vetuar ka pas kontroll atje, unë si kam berë kontroll, sepse deri kur ka pas afat nuk me kujtohet, sa i përket numrat e kam kontrolluar vetëm përpara, ndërsa nuk e kam këqyr aty ku janë te fshirë numrat sepse se kam dit qe ka aty numra, unë kam ra viktimë ngase se kam ditë aty duhet te ketë numra vetura, unë e di qe kamioni është i imi dhe as nuk është vjedhur as i falsifikim, dhe blerësi nuk me ka kompensuar asgjë sepse me ka than bjere veturën unë ti qes numrat.

3. Elementet e veprës penale

Me nenin 395 par 1 të KPRK-së, është parashikuar se veprën penale legalizim i përmbajtjes se rreme e kryen: kushdo **që vë në lajthim organin kompetent** që në një dokument publik, regjistër apo **libër të vërtetojë një çështje të pavërtetë**, të paraparë për të shërbyer si provë në një çështje ligjore.

Neni 28 i KPRK-së ka përcaktuar: kushdo **që me dashje ndërmerr veprime** për kryerjen e veprës penale **por vepra nuk është kryer** ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale.

Tentativa për të kryer vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me tre ose më shumë vjet burgim dënohet. Tentativa për të kryer ndonjë vepër penale tjetër, dënohet vetëm nëse shprehimisht parashihet me ligj.

4. Gjendja e vërtetuar faktike

Gjykata pas administrimit të provave, analizimit të tyre me shumë kujdes gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se: nuk është vërtetuar se i akuzuari I..... N..... ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, për shkak se me provat të cilat janë administruar nuk mund të mbështetet dyshimi i bazuar mirë në drejtim të elementeve të veprës penale nga neni 395 par. 1 të KPRK-se.

Prandaj nga dëgjim i të ekspertit të forenzikes **L.... M....**, dëshmitarit J... N..., administrimit të provave materiale dhe nga mbrojtja e të akuzuarit, gjykata ka vërtetuar se i akuzuari nuk ka kryer veprën penale për të cilin është akuzuar, ngase nga te gjitha këto prova nuk është vërtetuar se i pandehuri e ka **vë në lajthim organin kompetent** dhe gjatë këtyre veprimeve e ka **vërtetuar**

një çështje të pavërtetë, e cila do të shërbente si provë në një çështje ligjore, sepse vetë përshkrimi faktik i dispozitiv të atkzakzes ka përcaktuar se: pas ekzaminimit nga AKF rezulton se numri i karrocerisë së kësaj veture nuk gjendet aty ku duhet të jetë sipas standardit EUVID.

Prandaj për tu kryer kjo vepër penale nuk mjafton që numri i karrocerisë së veturës konkrete të mos gjendet aty ku duhet të jetë sipas standardit EUVID, sepse neni 395 i KPRK-së kërkon dashjen e të pandehurit që ta vejë në lajthim **organin kompetent** për të vërtetuar **një çështje të pavërtetë**.

Prandaj me vetë faktin se numri i shasis nuk është në vendin ku është dashur të jetë nuk përben elemente të kësaj vepre penale për të cilën është akuzuar i pandehuri, shtuar faktin se dy tiketa të plastikës janë në vendin e vetë dhe nuk ka ndërhyrje në to, për çka gjykata ka ardhur në përfundim se vetura në fjalë është orgjinale dhe pa ndërhyrje në të.

Deri ky konstatim gjykata ka ardhur duke u bazuar në deklaratën e ekspertit të forenzikës i cili në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar: gjatë inspektimit dhe ekzaminimit forenzik kemi konstatuar se kamionëta në fjalë e ka të dëmtuar (fshirë komplet numrin shtypur të karrocerisë i cili duhet të jetë pas gomës së parë në ballore pragu i djathtë dhe kemi vërejtur tiketën plastike të tipit e cila është e vendosur në shtyllën e derës së parë krahu i djathtë, **te e cila nuk është vërejtur ndonjë ndërhyrje**, ky numër i karrocerisë është dashur të jetë pas gomës së parë në ballore krahu i djathtë.

Ndërsa në vendin ku është dashtë të jetë i shtypur numri i karrocerisë janë vërejtur gjurmë veglash të cilat përdoren për rrafshimin dhe pastrimin e sipërfaqeve metalike, kjo është tera , dhe e bazuar në standardet evropian të veturave EUVID vetura duhet të ketë numrin e shtypur të karrocerisë sepse është identiteti i mjetit dhe posedon karakteristikat specifike të sigurisë,

Tutje i eksperti ka deklaruar: në bazë të standardit evropian të gjitha veturat që prodhohen për tregun evropian duhet të kenë numrin e karrocerisë i cili përmban 17 karaktere, **është i shkruar numri shasis në tiketën plastike dhe është numër vizual i cili është i vendosur nën parafango dhe në atë tikek nuk janë vërejtur ndërhyrje**.

Ndërsa pyetjen tjetër ; keni konstatuar se në tiketën plastike që gjendet në derë dhe në parafango e automjeti është i shkruar numri i shasis , a mund të thoni se a ka pas ndërhyrje qoftë në plastikën e derës qoftë në parafango, **eksperti është përgjigjur: nuk ka pas ndonjë konstatim që është vërejt diçka, këto dy tiketa janë origjinale mirëpo vetëm numri i shtypur i karrocerisë është i fshirë dhe në funde eksperti ka deklaruar** se përpos atë numri të shasis i cili është i fshirë **numër tjetër të shasis nuk ka të shtypur ngase kështu është i prodhuar**, në në laborator kemi terminologji shkencore dhe mund të deklarojmë se kjo veturë nuk është sipas standardit EU-VI-B dhe unë nuk mund të bëjë kualifikim në këtë rast nëse vetura është origjinale apo e falsifikuar, ndërsa numrat e cekur në kapakun e motorit me të njëjtin nuk mund të bazohem sepse është pjesë zëvendësuese shumë lehtë.

Poashtu gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar edhe në deklaratën e dëshmitarit J... N..... ngase nga dëshmia e këtij dëshmitari është vërtetuar

se i pandehur nuk ka pasur dashje për që të vë në lajthim organin kompetent e shtuar faktin se nga deklarimi i ekspertit të forenzikes nuk është vërtetuar se vetura ka pasur ndërhyrje, sepse edhe pasi ka shkuar dëshmitari J... N... herën e parë në *homologim e te njëjtit janë kanë kthyer veturën në QAK duke i thënë se kjo vetura nuk benë me u regjistruar*, arsyeja nuk i gjejshin numrat apo se di çka ka qenë ne pyetje mirëpo kur e kanë dergu mnë objektin tjetër atëherë se di çka kanë bërë sepse nuk me kanë len mu afriu, *mirëpo pastaj me kanë thirrë dhe me thanë merre veturën dhe pastaj ja ka kthyer të pandehurit.*

Poashtu nga mbrojta e të pandehurit gjykata ka vërtetuar faktin poashtu se i njëjti nuk kishte dashje që të vë në lajthim organin kompetent dhe nuk kishte ndërhyre ne veturën e tij ngasëse i njëjti edhe pse Q.. nuk i ka pranuar dëshmitarit J... N... që ta kaloj homologimin, i pandehur përsëri kishte shkuar ne Q.. me veturë për homologim duke theksuar: *ka dalë një person jahtë ka shiku se nuk i ka numrat e shtypur dhe me ka thënë qoje ne parking ne P...*, unë tani nuk e di se ku gjendet kjo veturë, ne garazh ku e kam ble veturën dokument nuk kam marr mirëpo ne tel i kam te dhënat se e kam ble dhe kam kontaktuar me te, kontratë skam pas për te, unë e kam blerë veturën nga personi privat, *unë kam menduar se kur është automjeti i regjistruar ne Z... nuk guxon qe te jetë i pa rregullt, pasi e kam ble unë e kam regjistrua ne Z...*

5. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Gjykata pas administrimit të provave, analizimit të tyre me shumë kujdes gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim për lirimin e te akuzuarit nga aktakuza , për shkak se me provat të cilat janë administruar nuk mund të mbështetet as dyshimi i bazuar mirë në drejtim të elementeve të veprës penale për të cilën ngarkohet i akuzuari me aktakuzë.

Gjykata duke vlerësuar deklaratën e ekspertit të forenzikes dhe raportit të tij, duke e krahasuar me dëshmitë e dëshmitarit J.. N.., me provat materiale si raporti i oficerit F.... M... i datës 04.06.2021, nga njoftimi i Q...- i datës, fotografitë e kryera nga QAK dhe Raporti i ekspertizës se AKF-se me numër 2021-..... i datës 07.9.2021 dhe me mbrojtën e të akuzuarit, i ka falur në tersi besimin sepse raporti i forenzikes përputhet ne tersi me gjendje faktike të vërtetuar si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata poashtu ka vlerësuar dëshmonin e dëshmitarit J... N.... dhe të njëjtën dëshmi i ka falë besimin si dëshmi kredibile dhe e vërtet, dhe e cila dëshmi e mbështet ne tersin mbroje e të pandehurit i cili ka theksuar se unë nuk e kam ditë se vetura ka ndonjë pa rregullsi ngase se kam menduar se vetura është ne rregull ngase e njëjta ka qenë e regjistër ne Zvicër.

Ndërsa gjykata poashtu ka vlerësuar dhe provat materiale të administruara ne shqyrtim gjyqësor si raporti i oficerit F.... M... i datës 04.06.2021, nga njoftimi i Q..- i datës, fotografitë e kryera nga QAK dhe Raporti i ekspertizës se AKF-se me numër 2021-..... i datës 07.9.2021 dhe ka ardhur ne përfundim se nuk është vërtetuar se i pandehur ka ndërmarr ndonjë veprim i cili mund tit atribuohet elementeve të veprës penale nga neni 359 par. 1 i KPRK-së.

Prandaj meqenëse mbrojta e të pandehurit nuk ka rendë me kundërshtim me asnjë provë formale apo materiale të administruar në shqyrtim gjyqësor gjykata ka vendosur për lirimin e të

pandehurit nga aktakuza, nga fakti se i pandehuri ka dërguar për homologim veturën F... e cila nuk i kishte numrat e shasis në vendin e vetë por e kishte të shlyer, nga fakti se ne veturë ishin edhe dy tiketa origjinale të konstatuara nga eksperti i forenzikes dhe faktin se vetura ishte e regjistruar edhe ne shtetin e Z.....

Andaj nga të cekurat me lartë gjykata ka ardhur në përfundim se duhet t'i falet besimi i plotë deklaratës së të akuzuarit, i cili e kishte mohuar kryerjen e veprës penale për të cilat është akuzuar, për shkak se një deklaram i tillë, gjenë mbështetje edhe në deklaramet e tij të mëparshme ne Polici dhe Prokurori, e duke marr parasysh se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite te ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas Kodit dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

6. Vendimi për lirimin e të akuzuarve nga akuza

Lidhur me pretendimet e Prokurorisë se i akuzuari ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata pas administrimit te provave, ka vlerësuar me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për te cilën akuzohet, andaj gjykata konform nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.3 të KPPRK-së të njëjtin e liroj nga akuza sepse akuza ka mbetur nën nivelin e dyshimit të arsyeshëm dhe jo në atë të bazuar mirë në prova të artikuleshme dhe të besueshme se i akuzuari me veprimin e tij të ketë kryer veprën penale për të cilin ngarkohet.

Me dispozitën ligjore te nenit 3 par. 2 te KPPRK-se është përcaktuar se: mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve te rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite te ligjit penale interpretohen ne favor te të pandehurit dhe te drejtave te tij sipas Kodit dhe sipas Kushtetutës se Republikës se Kosovës, andaj meqenëse ne rastin konkret te gjitha provat e administruara e dëshmojnë pafajësinë e te akuzuarit, për veç deklaratës së të dëmtuarës e cila nuk e ka mbështetur në prova të tjera dhe në kundërshtim me deklaratën e të pandehurit, e në kuptim te nenit 8 par. 1 dhe 2 te KPPRK-se gjykata vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimit

Me dispozitën ligjore të nenit 7 të KPRK-së është përcaktuar se: gjykata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm. Sipas dispozitave të parapara me këtë Kod, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij, dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t'i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit.

Me dispozitën ligjore të nenit 8 të KPRK-së është përcaktuar se: gjykata në punën e saj është e pavarur dhe vendos në bazë të Kushtetutës dhe ligjit. Gjukata merr vendim në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim gjyqësor. Prandaj asnjë nga provat e verifikuara ne shqyrtim gjyqësore nuk është vërtetuar se i pandehuri i ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar nga ana e Prokurorisë.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marrë duke u bazuar nënin 453 paragrafi 1 të KPP-së.

8. Vendimi për kthimin e sendit

Gjykata ka vendosur që të pandehurit të kthej veturën F... T...” ...- ., me nr. të shasis W....., me targa të huaja e me të dhëna të detajuara si në shkresat e lëndës, menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ngase në rastin konkret gjykata ka gjetur se nuk ka bazë ligjore për konfiskim të përhershëm të këtij sendi, meqenëse nga ekzaminimi fonezik i kësaj vetura ka dalë që e njëjta nuk është e falsifikuar e për çka gjykata ka marr edhe aktgjykim lirues, e po ashtu ky send nuk është i përfituar me kryerjen e veprës penale, dhe në rastin konkret nuk ekzistojnë bazat për konfiskim nga neni 276 i KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2021:225576, 08.05.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

Edona Berisha Kastrati

G j y q t a r i

Musë POVATAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.